

# Strategjia për Shqipërinë 2025-2030

Aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në 26 Shkurt 2025



**European Bank**  
for Reconstruction and Development



Përkthimi i tekstit origjinal të dokumentit është siguruar nga BERZH vetëm për lehtësinë e lexuesit. Ndonëse BERZH i ka kushtuar kujdes të veçantë sigurimit të vërtetësisë së përkthimit, BERZH nuk garanton apo miraton saktësinë e përkthimit. Mbështetja në këtë përkthim do të jetë në përgjegjësinë e vetë lexuesit. Në asnjë rrethanë BERZH-i, punonjësit e tij ose agjentët nuk do të jenë përgjegjës ndaj lexuesit ose kujtdo tjetër për çdo pasaktësi, gabim, fshirje, defekt, dhe/ose çdo ndryshim të përmbajtjes së përkthimit, pavarësisht nga shkaku, ose për asnjë dëmtim që rezulton prej tyre. Në rast mospërputhesh midis versionit në anglisht dhe versionit të përkthyer, mbizotëron ai në gjuhën angleze.

## Tabela e përmbajtjes

	Përmbledhje Ekzekutive	3
	Panoramë e Shqipërisë - BERZH	4
I.	Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2020-2024)	5
	Rezultatet Kyç të Tranzicionit të Arritura gjatë Periudhës së Strategjisë së Mëparshme	5
	Sfidat në Zbatim dhe Mësimet Kryesore	7
II.	Konteksti Ekonomik	8
	Konteksti Makroekonomik dhe Parashikimi për Periudhën e Strategjisë	8
	Sfidat Kyçe të Tranzicionit	9
III.	Përparësitë e Qeverisë dhe Angazhimi i Palëve të Interesit	11
IV.	Përcaktimi i Përparësive të Strategjisë për Shqipërinë	12
V.	Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve	13
VI.	Harta e Partnerëve Ndërkombëtarë që Plotësojnë Fushat e Punës së BERZH	15
VII.	Risqet e Zbatimit dhe Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	16
VIII.	Vlerësimi i Partneriteteve të Donatorëve	17
	Shtojcë - Vlerësimi i politikave	18

## Fjalorthi i Termave Kyç

ABI	Investim Vjetor në Biznes (ABI)	M&S	Prodhimi dhe Shërbimet
ASB	Këshilla për Biznesin e Vogël	MM	Memorandum Mirëkuptimi
CoOs	Vendet e veprimit	NBFI	Institucionet Financiare Jobankare
CP	Certifikata depozite	NDCs	Kontributet Kombëtare të Pikësnyuara
CPI	Indeksi i Çmimit të Konsumatorit	NECP	Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën.
CSO	Organizatë e Shoqërisë Civile	NEET	Të paarsimuar, të papunësuar dhe të paformuar
MS	Mjedisore & Sociale	NPL	Huatë e këqija
EA	Eficienca e Energjisë	ODA	Asistenca Zyrtare për Zhvillim
BEI	Banka Evropiane e Investimeve	OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
VNMS-ja	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social	OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së energjisë elektrike
ETS	Skema e Tregtimit të Emisioneve	PPP	Partneritet Publik Privat
BE	Bashkimi Evropian	PRS	Bashkëndarja e riskut të portofolit
FDI	Investim i Huaj Direkt	PFI	Institucion Financiar Partner
FI	Institucion Financiar	PTI	Ndikimi i Pritshëm i Portofolit
GCAP	Plani i Veprimit për Qytetin e Gjelbër	R&D	Kërkim dhe zhvillim
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto	GSH	Energjia e Rinovueshme
GEFF	Platforma e Financimit të Ekonomisë së Gjelbër	RO	Zyra e Përhershme
GET	Tranzicioni në Ekonomi të Gjelbër	RSF	Institucioni i bashkëndarjes së riskut
GS	Gazet Serrë	SCF	Kuadri strategjik dhe kapital
VSHB	Vlera e shtuar bruto	EJL	Evropa Juglindore
GVC	Zinxhiri Botëror i Vlerës	SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
ICA	Industria, Tregtia dhe Agrobiznesi	SOE	Ndërmarrje Shtetërore
ICDF	Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Fondi i Zhvillimit	TC	Bashkëpunimi teknik
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit	TFP	Produktet e Financimit të Tregtisë
IEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë	TMT	Teknologjia, Media, Telekomunikacioni
IFP	Institucioni Financiar Ndërkombëtar	VC	Kapitali i sipërmarrjes
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës	AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
TI	Teknologjia e Informacionit	VISP	Programi për Mbështetjen e Infrastrukturës Jetësore
MSME	Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme	BP	Ballkani Perëndimor

*Angazhimi për dhe zbatimin i parimeve politike të përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Krijimin e Bankës nga ana e Shqipërisë, kanë vijuar që prej miratimit të Strategjisë së mëparshme për Vendin, në përputhje me përpjekjet për zbatimin e agjendës gjithëpërfshirëse të reformave të BE-së.*

Shqipëria ka një vendndodhje strategjike në kryqëzimin e korridoreve kyç të transportit që lidhin Adriatikun me Detin e Zi që ofron akses në det, në burime të pasura natyrore dhe në popullsi të re. Pavarësisht ndikimit të krizës ekonomike globale, Shqipëria ka treguar qëndrueshmëri, me një rritje me rreth 6 për qind në vitet pas pandemisë, falë sezoneve turistike rekord. Megjithatë, konvergjenca e Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian vazhdon të jetë e ngadaltë, duke reflektuar një nivel jetese nën mesataren e BE-së dhe duke evidentuar boshllëqet e vazhdueshme.

Shqipëria përballet me disa sfida strukturore të ngjashme me homologët e saj nga Ballkani Perëndimor, siç janë papunësia e lartë mes të rinjve dhe rritja e ngadaltë e produktivitetit të punës. Pavarësisht përpjekjeve për të nxitur kompleksitetin ekonomik nëpërmjet investimeve të huaja, Shqipëria vazhdon të jetë importues neto i mallrave, duke eksportuar produkte me kompleksitet të ulët të sektorëve si veshjet, minierat dhe bujqësia. Ndonëse sektori bankar në Shqipëri është i qëndrueshëm dhe i mirëkapitalizuar, kreditimi për sektorin privat mbetet pas nivelit të vendeve homologe në Ballkanin Perëndimor.

Shqipëria, me një intensitet më të ulët të karbonit se sa homologët e saj, mbështetet kryesisht në hidrocentralet si burimi kryesor i energjisë elektrike. Megjithatë, kjo varësi e bën prodhimin të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe nevojën e mundshme për të importuar energji. Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt diversifikimit të burimeve energjetike dhe sigurimin e energjisë, duke përfshirë këtu lançimin e suksesshëm të një serie ankandesh të paneleve fotovoltaike dhe paneleve të erës me asistencën teknike të Bankës. Sigurimi i fleksibilitetit dhe kapacitetit të rrjetit për të integruar energjinë e rinovueshme, veçanërisht në kuadër të planit për të rritur prodhimin e energjisë rinovueshme dhe lidhjen me rrjetin e Bashkimit Evropian dhe tregjet e energjisë elektrike, do të jetë thelbësor për rritjen e reziliencës së sektorit të energjisë dhe për arritjen e qëllimit që Shqipëria të bëhet një eksportues neto energjie.

Që nga periudha e strategjisë së fundit të vendit, Shqipëria ka bërë progres në reformat e gjyqësorit dhe administratës publike, por do të jetë e nevojshme të kryhen përpjekje të mëtejshme për të adresuar informalitetin në ekonomi, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe ndërlidhjen rajonale dhe për t'u përafëruar me kuadrin e acquis të BE-së. Më 15 tetor 2024, BE-ja hapi Grupkapitullin 1 ("Themeloret") të negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, i cili përbëhet nga pesë kapituj negociues dhe tre fusha, përfshirë këtu edhe kapitujt për Shtetin e së Drejtës. Ky ka qenë një zhvillim historik. Anëtarësimi në BE mbetet faktori i jashtëm kyç për reformat: me progresin e fundit në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe Planin i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor do të ndihmojnë në përsheptimin e reformave strukturore në sektorin e biznesit, zhvillimin e kapitalit njerëzor, tranzicionin e gjelbër dhe qeverisjen, duke shtuar besimin te investitorët. BERZH do të mbështetet në praninë e saj të fuqishme dhe në partneritetet e forta me sektorin publik dhe privat për të ndihmuar Shqipërinë të bëhet më konkurruese, e qëndrueshme dhe më e integruar në tregjet rajonale dhe globale. Ndaj, Banka do të përqendrohet në këto përparësi gjatë periudhës 2025-2030 në Shqipëri:

- Përsheptimin e tranzicionit të Shqipërisë në Ekonominë e Gjelbër
- Mbështetjen e gatishmërisë së sektorit privat për anëtarësimin në BE, nëpërmjet qasjes më të mirë në financime dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor
- Forcimin e qeverisjes ekonomike, përmirësimin e klimës së investimit dhe avancimin e infrastrukturës

# Panoramë e Shqipërisë - BERZH



European Bank  
for Reconstruction and Development


## Veprimtaritë e Investimit të BERZH në Shqipëri (deri në tetor 2024)

Portofoli	€1,117m	Projekte aktive	66
Pjesa e kapitalit	1%	Asete Operacionale	€532m
Aksionet e Sektorit Privat <sup>1</sup>	54.8%	Investim neto gjithsej	€2,217m


## Shifrat kontekstuale për Shqipërinë

	Shqipëri	Krahasimet
Popullësia (milion) <sup>3</sup> (2023)	2.4	KOS 1.8 MNE 0.6 MKD 1.8
PBB-ja për frymë, (konstante PPP, ndërkombëtare. \$) <sup>3</sup> (2023)	18,037	KOS 14,294 MNE 27,037 MKD 23,172
Dendësia e re e biznesit <sup>4</sup> (Regjistrimet e reja për 1,000 banorë, 2022)	1.8	KOS 6.0 MNE 8.0 MKD 4.6
Papunësia (%) <sup>5</sup> (2023)	10.7	KOS 12.6 MNE 13.4 MKD 13.2
Përqindja e papunësisë së të rinjve (%) <sup>5</sup> (2023)	25.6	KOS 21.3 MNE 29.5 MKD 29.7
Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore (%) <sup>5</sup> (2023)	58.1	KOS 19.4 MNE 52.2 MKD 42.5
Emetimet e CO <sub>2</sub> për frymë (in t) <sup>6</sup> (2022)	1.7	KOS 4.8 MNE 3.7 MKD 3.6


## ABI dhe operacione




## Përbërja e Portofolit (€m)



## Dinamika e Portofolit (€m)



## Mangësitë e Tranzicionit<sup>2</sup>



1 Pjesë private e investimeve kumulative 5-vjeçare; 2 Cf. Raporti i Tranzicionit i BERZH-it 2024-2025; 3.FMN WEO Tetor '24; 4 Anketa e Sipërmarrjes dhe baza e të dhënave e BP-së; 5 ILO dhe INSTAT; 6 Buxheti Global i Karbonit (2023)




# 1. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2020-2024)


## 1.1. Rezultatet Kyç të Tranzicionit të Arritura gjatë Periudhës së Strategjisë së Mëparshme (1/2)

### Harmonizimi Strategjik 2020-2024


#### Investim Vjetor në Biznes (ABI)



#### Bashkëpunimi teknik dhe fondet e investimit të përbashkët<sup>1</sup>



#### Performanca e Ndikimit në Tranzicion<sup>2</sup>



### Prioriteti 1

### Mbështetja për përmirësimin e qeverisjes në të gjithë ekonominë

#### Rezultatet kyçe të tranzicionit

- Promovimi i vazhdueshëm i një klime më të favorshme për biznesin, duke mbështetur Këshillin Shqiptar të Investimeve dhe duke inkurajuar dialogun konstruktiv mes sektorit publik dhe privat për të adresuar shqetësimet e bizneseve. Këshilli ka miratuar rreth 340 rekomandime, prej të cilave rreth 48% janë zbatuar nga institucionet publike, duke u shndërruar në legjislacion, procese dhe praktika më të përmirësuara.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit Rural dhe Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, kryesisht duke shtuar aftësinë e tyre për të iniciuar dhe shqyrtuar në mënyrë efikase çështjet, do të kontribuojë në rritjen e pajtueshmërisë së biznesit me rregullat e konkurrencës, në përputhje me acquis të BE-së.
- Mbështetja e avancimit të komercializimit të Korporatës Elektroenergetike Shqiptare (KESH), në pronësi të shtetit, si pjesë e një kredie komerciale prej 9 milion € për ndërtimin e një centrali FV lundrues; gjithashtu asistoi në zbatimin e CGAP-it të tij, duke mundësuar reforma si ndarja e operatorit të shpërndarjes nga furnizuesi me pakicë.
- Mbështetja e ngritjes së kapaciteteve për Hekurudhat Shqiptare do të realizohet përmes 3 TC-ve, të cilat kanë si objektivi zbatimin e kontabilitetit të SNRF-ve, hartimin e një Plani të Menaxhimit të Aseteve dhe zhvillimin e sistemeve për menaxhimin mjedisor. Asistimi në zhvillimin e një strategjie të burimeve njerëzore të përgjegjshme gjinore dhe një Plan Veprimi për Mundësi të Barabarta, për të shtuar angazhimin e grave në pozita teknike dhe menaxheriale brenda kompanisë.
- Kredia prej 70 milion € e VISP, ndihmoi në përmirësimin e qeverisjes së OSHEE-së, SOE-së më të madhe në Shqipëri dhe furnizuesit të vetëm të energjisë për klientët e rregulluar, duke mbështetur zbatimin e një plani veprimi kundër korrupsionit dhe duke përmirësuar kodin e saj të sjelljes për të përfshirë çështjet gjinore dhe programet për zhvillimin e aftësive.
- Ofrimi i asistencës teknike për Agjencinë e Prokurimit Publik në hartimin e akteve nënligjore për dokumentet standarde të tenderit me synim harmonizimin me standardet përkatëse të BE-së.

1. Grafiku i referohet shumave të rezervuara në periudhën 2020-2023

2. Performanca e ndikimit në tranzicion pasqyron gjasat e pritshme që kanë projektet për të pasur ndikim në tranzicion pas nënshkrimit të tyre. Përlogaritjet bazuar në portofolin aktiv të maturuar (> 2 vjet)




# 1. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2020-2024)

## 1.1. Rezultatet Kyç të Tranzicionit të Arritura gjatë Periudhës së Strategjisë së Mëparshme (2/2)

### Prioriteti 2

Nxitja e konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe përfshirjes nëpërmjet aksesit më të madh në financim dhe transferimit të dijeve

#### Rezultatet sasore kyç




#### Rezultatet kyçe të tranzicionit

- Gjatë viteve 2020-2023, u lançuan 243 projekte ASB për SME-të vendase, prej të cilave 62 ishin në sektorin e hoteleri turizmit, përveç programit Mentorship Acceleration, nën Star Venture, që mbështeti 12 startup-e shqiptare me potencial të lartë.
- U ofruan instrumente novatore për lehtësimin e kapitalit dhe bashkëndarjen e riskut për PFI-të, duke liruar burime për kreditimin e NVM-ve, përfshirë një kredi prej 50 milionë eurosh për MREL, e para në BP, si dhe mbi 200 milionë euro garanci të pafinancuara sipas Kuadrit të Garancisë për Rritje.
- Mbështeti Këshillin e Aftësive në Sektorin e Turizmit dhe prezantoi mundësi të reja për trajnim dhe mësim në lidhje me produktet dhe shërbimet turistike, duke synuar 2,000 individë.
- Vijoi projektin e zhvillimit të Infrastrukturës dhe Turizmit në Shqipëri, së bashku me grantet e BE-së, me synim përmirësimin e konkurrueshmërisë së turizmit tokësor nëpërmjet infrastrukturës më të mirë bashkiake dhe transportit.
- U nënshkruan 32 nënhua RSF me 4 banka partnere për një vlerë prej 81 milion € ABI, të diversifikuara mirë midis SME-ve dhe korporatave në sektorët e ICA-së dhe Energjisë.
- U rrit qasja në financime për më shumë se 6.000 agrobiznese, fermerë dhe kompani turistike nëpërmjet Kuadrit të Mbështetjes së Agrobiznesit dhe Turizmit në partneritet me 7 PFI.
- U mbështetën IHD-të në sektorët e minierave, burimeve të rinovueshme dhe shitjes me pakicë, duke përfshirë një hua prej 28 milionë dollarësh për të ndihmuar grupin turk Ylidirim në blerjen e Albchrome, 29 milionë euro për Voltalia për ndërtimin e një centrali fotovoltaike diellor dhe 9 milionë euro për zgjerimin rajonal të supermarketeve Lidl.

### Prioriteti 3

Forcimi i diversifikimit të energjisë dhe tranzicionit në nivele të ulëta karboni

#### Rezultatet sasore kyç



#### Rezultatet kyçe të tranzicionit

- Ndihmoi Shqipërinë të zgjeronte prodhimin e energjisë së rinovueshme duke kombinuar financimin dhe asistencën teknike për nisjen e ankandeve të energjisë së rinovueshme. Deri më sot ka mbështetur 3 ankande diellore të suksesshme dhe ankandin e parë për energjinë e erës, me mbi 750 Më të kapaciteteve të energjisë së rinovueshme. Në vijim të ankandit të parë të energjisë diellore, u bashkë-financua impianti diellor i Karavastasë (€29m); impianti i parë fotovoltaike me shkallë të gjerë të shërbimeve në Shqipëri.
- Mbështetja e vazhdueshme për agjendën e reformës në sektorin e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë ngritjen e Operatorit RES dhe ndryshimet në Ligjin e Sektorit të Energjisë për t'u përafuar me Direktivat përkatëse të BE-së.
- U mbështet rehabilitimi gradual i rrjetit hekurudhor, duke përfshirë: përparimin në zbatimin e Programit të Hekurudhës Shqiptare, ku rreth 50% e punimeve kanë përfunduar në fund të vitit 2023 në linjën Tiranë-Durrës dhe lançimi i rehabilitimit të linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit, për të cilën janë siguruar mbi €150m investime në grante nga eBIF.
- U mbështet përmirësimi i ndërlidhjes rrugore të vendit, duke përfshirë përparimin në Projektin e Ndërlidhjes Rajonale dhe Lokale, për të cilin janë siguruar 50 milionë dollarë amerikanë për të përmirësuar tre segmente rrugore me rëndësi kyç për zhvillimin e ekonomisë vendore.



# 1. Zbatimi i Strategjisë së Mëparshme (2020-2024)

## 1.2. Sfidat në Zbatim dhe Mësimet e Kyç

### Konteksti i zbatimit:

Gjatë periudhës së fundit të strategjisë, Shqipëria është përballuar me disa sfida, duke filluar me tërmetin e vitit 2019, ndjekur nga pandemia e COVID-19 dhe së fundmi kriza energjetike dhe ndërprerja e zinxhirit global të furnizimit. Pavarësisht ndikimit të krizës ekonomike botërore, vendi ka treguar qëndrueshmëri dhe ka pasur një rritje prej mesatarisht 6 për qind në vitet pas pandemisë falë sezoneve turistike rekord. Fluksi i investimeve të huaja ka nxitur rritjen në sektorin e turizmit në Shqipëri, duke tejkaluar shumë vende fqinje. Megjithatë, produktiviteti dhe standardet e jetës mbeten nën mesataret e BE-së, duke reflektuar boshllëqe në të gjitha aspektet e tranzicionit, veçanërisht në qeverisje. Ndonëse ka pasur përmirësim në efektivitetin e qeverisë dhe cilësinë rregullatore, përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të trajtuar informalitetin, për të përmirësuar klimën e biznesit, ndërlidhjen rajonale dhe përafrimin e kornizave institucionale me acquis të BE-së. Shqipëria, vend me një intensitet më të ulët të karbonit se sa homologët e saj, mbështetet kryesisht në hidrocentralet si burimi kryesor i energjisë elektrike. Kjo varësi e bën prodhimin e energjisë të pambrojtur ndaj ndryshimeve të motit, duke sjellë nevojën për t'u mbështetur në importin e energjisë dhe duke e theksuar nevojën për burime energjie më të larmishme dhe zgjerimin e kapacitetit të rrjetit për të përmirësuar sigurinë energjetike. Anëtarësimi në BE mbetet një synim kyç: progresi i kohëve të fundit në negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe Plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor do të ndihmojnë në përshpejtimin e reformave strukturore në sektorin e biznesit, zhvillimin e kapitalit njerëzor, tranzicionin e gjelbër dhe qeverisjen, duke rritur besimin te investitorët.

### Sfidat në Zbatim

- Kufizimi i kapaciteteve zbatuese në sektorin publik dhe SOE-të, që sjell vonesa në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve.
- Hapësira e kufizuar fiskale për investime në infrastrukturën thelbësore.
- Krahas progresit, sfidat strukturore si prania e informalitetit, si dhe mangësitë në zbatimin e ligjit dhe të drejtat e paqarta pronësore, kthehen në pengesë për klimën e biznesit dhe qasjen në financime.
- Në sektorë të rinj kyç si energjia dhe turizmi, mungesa e punëtorëve të aftë po bëhet kritike.

### Mësimet Kyçe dhe Hapat e Ardhshëm

- Të kombinohet asistenca teknike dhe investimeve për të ngritur kapacitetet e SOE-ve për zbatimin e projekteve të infrastrukturës strategjike.
- Të shfrytëzohen fondeve në kuadër të Programit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për projektet prioritare të infrastrukturës dhe energjisë.
- Të ofrohet asistencë e vazhdueshme teknike dhe dialog për politikat për të përmirësuar klimën e investimeve, duke mbështetur zbatimin e Agjendës së Reformës sipas Planit të Rritjes së BE-së.
- Të përshkallëzohet mbështetja për zhvillimin e aftësive duke shtuar mundësitë e arsimit dhe trajnimit profesional në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat dhe publik.





## 2. Konteksti Ekonomik

### 2.1. Konteksti Makroekonomik dhe Parashikimi për Periudhën e Strategjisë

#### Shqipëria - Treguesit kryesorë makroekonomikë

	2020	2021	2022	2023
Rritja e PBB-së (% v në v)	-3.3	9.0	4.8	3.9
Inflacioni i CPI-së (% mesatarisht)	1.6	2.0	6.7	4.8
Balanca e Qeverisë (% e PBB-së)	-6.7	-4.6	-3.6	-1.3
Balanca aktuale e llogarive (% e PBB-së)	-8.6	-7.7	-5.9	-1.2
IHD Neto (% e PBB-së) [minusi tregon hyrjet]	-6.7	-6.5	-6.6	-5.8
Borxh i jashtëm (% e PBB-së)	63.9	64.0	54.1	46.3
Rezervat bruto (% e PBB-së)	29.5	32.6	27.4	26.8
Borxhi bruto qeveritar i përgjithshëm (% e PBB-së)	73.9	74.1	64.1	57.5
Përqindja e papunësisë (%)	11.7	11.5	10.9	10.7
PBB nominale (miliard \$)	15,242	18,032	19,017	23,547

Burimi: FMN dhe autoritetet kombëtare

**Rritja ekonomike e moderuar që nga Kriza Globale Financiare** nga rreth 5.5 për qind 6 vite para krizës në 2.7 për qind në dekadën pas krizës, deri në fillimin e pandemisë Covid. Pas pandemisë, rritja ka arritur në pothuajse 6.0 përqind mesatarisht çdo vit, por është i nevojshëm përshtetja e mëtejshme të rritjes afatgjatë për të nxitur konvergencën në nivelet e BE-së.

**Inflacioni ishte i qëndrueshëm në dekadën e fundit dhe më i ulëti në rajon për vitet 2022-2023** gjatë goditjes globale nga inflacioni, për shkak të politikës së shtrënguar monetare dhe vlerësimit të monedhës prej rreth 12.5 për qind në dy vitet e fundit.

**Deficiti i llogarisë korente u ngushtua në dekadën e fundit**, me rritjen e eksporteve të shërbimeve dhe rritjen e fluksit hyrës të IHD-ve, të cilat nxitën eksportet e prodhimit. Megjithatë, kompleksiteti i ulët i ekonomisë mbetet një problem, dhe mbiqimi i konsiderueshëm i kursit të këmbimit ka ndikuar në ecurinë e eksportit të mallrave kohët e fundit.

**Deficiti fiskal është në rënie që nga pandemia**, por do të nevojiten reforma fiskale të mëtejshme në vitet në vijim për të shtuar arkëtimin e të ardhurave dhe për të përmirësuar alokimin e shpenzimeve në projektet e infrastrukturës, energjisë së qëndrueshme dhe politikave arsimore për të nxitur rritjen. Borxhi publik po ashtu është në rënie dhe aktualisht vlerësohet të jetë i moderuar në 57.8 për qind.

**Rritja afatshkurtër do të mbetet pak më poshtë se 4 për qind në vitin 2024 dhe 2025** për shkak të sektorit të fortë të hotelerisë dhe përmirësimit të perspektivës së rritjes globale. Risqet kryesore negative mund të lindin nga thatësira e mundshme, që do të ndikonte negativisht në prodhimin bujqësor dhe furnizimin me energji elektrike. Megjithatë, në periudhën afatmesme, rritja pritet të shënojë rënie nëse nuk ka përmirësime në klimën e biznesit dhe në investimet në kapitalin njerëzor.




## 2. Konteksti Ekonomik

### 2.2 Sfidat Kyçe të Tranzicionit (I/II)

#### Konkurrues

- Ndonëse në rritje, produktiviteti i punës është ende nën nivelet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke rezultuar në një konvergencë të ngadaltë me të ardhurat mesatare të BE-së.
- Tregtia e lirë është në nivele të ulëta në krahasim me vendet homologe, (rreth 75 për qind e PBB-së) pavarësisht anëtarësimit të hershëm në ëTO (2000).
- Struktura e ekonomisë ka pësuar ndryshime të rëndësishme në dekadat e fundit, duke kaluar nga bujqësia me vlerë të ulët të shtuar dhe produktivitet të ulët, si industria e përpunimit të veshjeve, në sektorin e turizmit, megjithatë, ka ende vend për sofistikim të mëtejshëm të saj.
- Përmirësimi është më se i dukshëm në disa fusha kyç (politikat e arsimit, bujqësisë dhe antikorrupsionit), ndërsa përparimi në teknologji dhe inovacion mbetet më pas.


#### Indeksi i konkurrueshmërisë 2024 (0-5 më e mira)



#### I Mirë Qeverisur

- Treguesit e qeverisjes kanë mbetur pas vendeve homologe, kryesisht për shkak të mangësive në qeverisjen korporative, përfshirë këtu kontrollin e brendshëm, të drejtat e aksionarëve, strukturën e bordit dhe transparencën.
- Progresi i bërë në dy dekadat e fundit për të përmirësuar efektivitetin e qeverisë dhe cilësinë e sistemit rregullator.
- Në vitet e fundit janë bërë përpjekje nëpërmjet reformave për të përmirësuar efektivitetin e gjyqësorit dhe luftës kundër korrupsionit, dhe ndonëse ka disa rezultatet të dukshme, zbatimi i plotë nuk është arritur ende.
- Zbatimi rregullator vazhdon të jetë problem dhe procedurat e ndërlikuara administrative duhet të jenë më efikase.
- Qeverisja e SOE-së duhet të përmirësohet përmes transparencës më të lartë në performancë dhe llogaridhënie.


#### Indeksi WPJ i Shtetit të së Drejtës (1-140 më keq)



#### e Gjelibër

- Intensiteti i ulët i karbonit në krahasim me standardet e BE-së ka ardhur për shkak të mbështetjes tek hidrocentralet si burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike, megjithatë, është e nevojshme të zhvillohen burime të tjera të rinovueshme dhe të larmishme për të garantuar rezistencë në furnizimin me energji elektrike dhe për të reduktuar risqet fiskale.
- Në përgjithësi korniza rregullatore është në përputhje me Paketën e Tretë Energjetike të BE-së, por NECP është ende nën shqyrtim dhe nuk është miratuar. Shqipëria ka miratuar një Ligj të ri për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet Rinovueshme në Prill 2023 që për afron legjislacionin e saj me paketën e BE-së për Energjinë e Pastër.
- Pavarësisht varësisë dominante nga energjia hidrike, burimet e rinovueshme po zhvillohen me ritme shumë të shpejta në dy vitet e fundit duke e katërfishuar prodhimin në 9 muajt e parë të 2024 krahasuar me 2023.

#### Intensiteti i karbonit (Emetimi i CO2 në kg për 2017 PPP \$ të PBB-së)



Shënim: ëB-4 përfshin Bosnje dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë



## 2. Konteksti Ekonomik

### 2.2 Sfidat Kyçe të Tranzicionit (II/II)

#### Përfshirës




- Përmirësimi i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, si dhe rënia graduale e papunësisë, ndikohen nga sfidat e vazhdueshme demografike dhe presioni i lartë nga emigracioni.
- Papunësia afatgjatë përbën rreth tre të katërtat e papunësisë totale, më shumë se dyfishi i mesatares së BE-së, duke treguar mospërputhje të qenësishme midis kërkesës dhe ofertës së tregut të punës.
- Pjesëmarrja e të rinjve në tregun e punës në Shqipëri mbetet e ulët, ku papunësia e të rinjve është dukshëm më e lartë se shkalla e papunësisë së të rriturve.
- Ndonëse është më i ulët se në vendet e Ballkanit Perëndimor, hendeku gjinor në pjesëmarrjen në tregun e punës vazhdon të jetë i pranishëm, ku pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore është në nivelin 58 për qind.

#### I Integruar

- Duke u nisur nga niveli i ulët i stokut të kapitalit publik, qeveria po i jep përparësi investimeve publike për të përbushur kërkesën në rritje për përmirësimin e transportit si dhe infrastrukturën bashkiake.
- Dekadat e tëra të mungesës së investimeve kanë rezultuar në degradimin e infrastrukturës hekurudhore, e cila po rindërtohet pothuajse tërësisht, për të cilën do të nevojitet investime të konsiderueshme në vitet e ardhshme.
- Ndërlidhja rrugore po përmirësohet, por do të nevojiten përpjeke të mëtjeshme për të përafuar sigurinë rrugore në standardet e BE-së.
- Pavarësisht përmirësimeve në treguesit e përzgjedhur të logjistikës, si cilësia dhe efikasiteti i doganave, performanca e përgjithshme e logjistikës së Shqipërisë vazhdon të mbetet prapa BE-së dhe homologëve të saj rajonalë.
- Ndërlidhja digjitale karakterizohet nga pabarazi të mëdha rajonale.
- Në dekadën e fundit, vendi e rriti stokun e tij të IHD-ve trefish në terma nominalë, por stoku i IHD-ve për frymë mbetet ende pas vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të BE-11.

#### Rezistues

- Sektori bankar është i vogël, por i mirëkapitalizuar; i dominuar nga bankat me pronësi të huaj. Treguesit makroprudencialë janë duke u përmirësuar që nga kriza globale financiare, por kredia e brendshme për sektorin privat mbetet e ulët.
- Niveli i lartë i përdorimit të monedhës euro (rreth 50 për qind) është një risk, duke marrë parasysh luhatjet e kursit të këmbimit.
- Tregjet e kapitalit janë pak të zhvilluara dhe jolikuide. Pavarësisht kuadrit rregullator të përmirësuar dhe mjedisit makro mbështetës, infrastruktura e tregut dhe diversifikimi i aktiveve financiare mbeten të pazhvilluara.
- Sektori i energjisë është shumë i prekshëm ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh varësinë e madhe nga hidrocentralet. Fokusi në vitet e fundit ka qenë diversifikimi i burimeve të energjisë, rehabilitimi i hidrocentraleve të vjetra dhe zgjidhja e pengesave në transmetim.





# 3. Përparësitë e Qeverisë dhe Angazhimi i Palëve të Interesit

## 3.1 Përparësitë e Qeverisë për Reforma

Për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit në BE, Komisioni Evropian miratoi në tetor 2024, Agjendën e Reformës së Shqipërisë sipas Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Agjenda e Reformës bazohet në rekomandimet ekzistuese duke përfshirë nga Paketa vjetore e Zgjerimit dhe Programet e Reformës Ekonomike. Fushat prioritare të reformës përfshijnë:

- **Klima e biznesit:** Mobilizimi të të ardhurave të brendshme dhe përmirësimi i shërbimeve dhe politikave shtetërore të kadastrës për përdorimin e tokës; forcimi i qeverisjes së Ndërmarrjeve Shtetërore dhe Ndhmës Shtetërore; përmirësimi i kuadrit për tërheqjen e investimeve, në veçanti IHD-ve, ngritja e sistemeve inteligjente të transportit të njerëzve dhe transportit elektronik të mallrave; Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, dhe integrimi i zinxhirit të vlerës së industrive të përzgjedhura me potencial rritjeje.
- **Kapitali njerëzor:** Përditësimi i kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm dhe rishikimi i sistemit të APF-së; Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve për t'u përafuar me nivelet përkatëse të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve;
- **Digjitale:** Avancimi i aftësive digjitale re të rinjtë dhe të sigurimi i pajisjeve të TIK-ut për shkollat dhe universitetet publike; pajtimi me Rregulloren e Identitetit Digjital; përditësimi i kornizës së reziliencës kibernetike dhe forcimi i institucioneve përkatëse; sigurimi i një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme; përmirësimi i klimës së favorshëm për bizneset inovative;
- **Tranzicioni i gjelbër:** Zbatimi i paketës së integritit të energjisë elektrike dhe sigurimi i harmonizimit me kërkesat e Komunitetit të Energjisë; Ndërprerja graduale e ndërhyrjes publike në përcaktimin e çmimeve të furnizimit me energji elektrike dhe adresimi i varfërisë energjetike; Zhvillimi i planit transparent dhe konkurrues të ankandit për energjinë e rinovueshme; Zbatimi i Direktivës për Energjinë e Rinovueshme; Zhvillimi i mekanizmit për çmimin e karbonit me synimin për të krijuar një ETS deri në vitin 2030; Miratimi dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave dhe skemës së efikasitetit të energjisë.
- **Shteti i së drejtës:** Krijimi i një Zyre për Rikuperimin e Pasurisë, duke kontribuar në përmirësimin e proceseve të sekuestrimeve dhe konfiskimeve; Forcimi i kapaciteteve institucionale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; Promovimi i kornizës për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave; Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies gjyqësore përmes një transparence më të mirë; Përmirësimi i lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet evropiane.

## 3.2 Fushat e Reformave të Rëna Dakord Gjerësisht midis BERZH dhe Autoriteteve

- Roli në BERZH-it në mbështetjen e progresit ekonomik të Shqipërisë sipas agjendës së integritit në BE, duke nxitur gatishmërinë e sektorit privat për t'u bashkuar me tregun e vetëm me fokus konkurrencën, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e aftësive.
- Përdorimi i ëBIF-së për të vazhduar mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës së Shqipërisë, duke përfshirë kanalizimin e investimeve dhe asistencës teknike në sektorin hekurudhor.
- Lehtësimi i tranzicionit të gjelbër, duke përfshirë diversifikimin e burimeve të energjisë dhe promovimin e eficiencës së energjisë në ekonomi, duke mobilizuar kapitalin privat.

## 3.3 Mesazhet Kyçe nga Shoqëria Civile për BERZH

- OSHC-të evidentuan që klima e biznesit të Shqipërisë dhe pjesëmarrja civile në procesin e anëtarësimit në BE ka nevojë për përmirësimin dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të nismave novatore të sektorit privat.
- OSHC-të inkurajuan BERZH-in që të vijojë në adresimin e (i) pabarazive gjinore në tregun e punës, (ii) aksesin në financa për gratë sipërmarrëse dhe (iii) përgjegjshmërinë gjinore në projektet e saj duke vazhduar të mbështesë zhvillimin e objektivave të qarta, treguesve, vlerësimeve dhe planeve të veprimit.
- OSHC-të vunë në dukje nevojën për të shtuar mbështetjen për tranzicionin e gjelbër të Shqipërisë duke (i) nxitur ekonominë e gjelbër dhe qarkulluese, (ii) duke promovuar përdorimin e energjisë së rinovueshme brenda vendit, (iii) duke ndihmuar në përmirësimin e zbatimit të vlerësimeve të ndikimit në mjedis dhe (iv) mbrojtjen e burimeve natyrore dhe mjedisit.



# 4. Përcaktimi i Përparësive të Strategjisë për Shqipërinë

## Çfarë duhet të ndryshojë? (Diagnostikimi i Vendit)

- Intensiteti i ulët i karbonit në krahasim me nivelin e BE-së vjen si rezultat i mbështetjes së konsiderueshme të hidrocentralet si burim kryesor të prodhimit të energjisë elektrike, që e bëjnë këtë prodhim të ndjeshëm ndaj kushteve klimatike dhe modeleve të reshjeve.
- Pengesat e konsiderueshme në rrjetet e transmetimit të energjisë elektrike
- Cenueshmëria e lartë ndaj nxehtësisë ekstreme dhe thatësisë, si dhe fakti që është vendi më i cenushtëm në BP ndaj rrëshqitjeve të dheut dhe tërmetejeve.

- Produktiviteti i punës, i matur sipas PBB-së për punëtor, që është rreth gjysma e niveleve të BE-11.
- Shqipëria ka mbetur pas vendeve homologe në rajon për sa i përket inputeve dhe outputeve të inovacionit.
- Kalimi në sektorin e turizmit kontribuon në diversifikimin më të lartë të ekonomisë, por karakterizohet nga niveli i ulët i sofistikimit.
- Ndërmjetësimi financiar mbetet i ulët, duke penguar aksesin në financa.
- Papunësia e të rinjve është ende shumë më e lartë se shkalla e papunësisë për individët në moshë pune.
- Hendeku gjinor në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore vazhdon të jetë i pranishëm.

- Qeverisja e SOE-ve kërkon përmirësime, përfshirë një rritje të transparencës dhe llogaridhënies.
- Hendeku në infrastrukturë si dhe hapësira e kufizuar fiskale janë barrierë në ngushtimin e hendekut të produktivitetit me BE-në.
- Infrastruktura digjitale është e pazhvilluar veçanërisht në zonat rurale.
- Performanca e logjistikës ka rënie dhe mbetet pas vendeve homologe të rajonit dhe BE-së.

## A mund të ndryshohet? (Ekonomia Politike)

- Ekonomia e parë e BP-së që miratoi NECP në 2021, e cila tani po rishikohet për t'u përafuar më tej me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Dekretimi i një ligji të ri për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, në përputhje me Paketën e Energjisë së Pastër
- Lancimi i tregut të parë të përbashkët të energjisë elektrike në BP me Kosovën, për të garantuar sigurimin e furnizimit me energji dhe konkurrencën e çmimeve.
- Strategjia afatgjatë e rinovimit, që synon EE-në në ndërtesat publike/private, është në zhvillim e sipër

- Ndryshimet e miratuara në ligj për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve, që përfshin ngritjen e Agjencisë Shqiptare për Startup-et.
- KE ka dhënë dritën jeshile për t'iu bashkuar SEPA-s, duke nxitur ndërlidhjen financiare dhe duke lehtësuar tregtinë ndërkombëtare.
- Miratimi i Strategjisë së Re Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2023-2030)
- Prezantimi i një Strategjie Kombëtare për Rininë për vitet 2022-2029 dhe lancimi i Garancisë Rinore, që synon përmirësimin e punësueshmërisë së të rinjve

- U miratua Strategjia Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike (2023-2030), me fokus transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin në menaxhimin e burimeve publike.
- Strategjia kombëtare e transportit 2021-2025, e cila përfshin masa prioritare për transportin intermodal dhe të kombinuar nuk është miratuar ende.
- Që nga viti 2021, Shqipëria ka miratuar ose ka përditësuar disa ligje për t'u përafuar me Planin e Veprimit Hekurudhor të BE-së, ndërkohë që kapacitetet dhe infrastruktura fizike në këtë sektor janë ende në zhvillim.

## Çfarë mund të bëjë Banka? (Aftësitë Institucionale)

- Ekspertiza në mbështetjen e projekteve të RES-ve dhe plotësimi i nevojave për EE/RE nëpërmjet investimeve dhe këshillimit për klientët mbi teknologjitë/praktikat e gjelbra.
- Aftësia për të mobilizuar kapitalin privat dhe për të rritur financimin e gjelbër përmes PFI-ve vendore
- Përvoja në mbështetjen e zhvillimit të klimës së qeverisjes së korporatave

- Ekspertiza në mbështetjen e konkurrencës, digitalizimit dhe inovacionit me struktura të larmishme financimi dhe këshilla teknike.
- Historiku i rezultateve në nxitjen e zhvillimit të tregut financiar nëpërmjet instrumenteve novatore dhe politikave këshilluese.
- Përvoja në mbështetje të reformës në arsimin profesional dhe zgjerimin e aksesit për aftësi dhe mundësi punësimi.

- Mbështetja e synuar e politikave për të përmirësuar klimën e biznesit duke përdorur platforma të tilla si Këshilli i Investimeve.
- Përvoja e shfaqur për të ndihmuar korporatat dhe SOE-të që të arrijnë standarde më të larta të qeverisjes dhe klimës së korporatave, nëpërmjet investimeve dhe shërbimeve këshillimore.
- Historiku i suksesshëm i rezultateve në financimin e projekteve të transportit ka kontribuar në përmirësimin e tregtisë dhe ndërlidhjes në vend.

## Përparësitë Strategjike (2025-2030) Çfarë duam të shohim në vitin 2030

<b>Përrshpejtimi i tranzicionit të Shqipërisë në Ekonominë e Gjelbër</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diversifikimi dhe përrshkallëzimi i burimeve të energjisë së rinovueshme</li> <li>Mbështetja e, qëndrueshmërisë në të gjithë ekonominë</li> <li>Përrmirësimi i rezistencës ndaj klimës dhe qeverisjes së gjelbër</li> </ul>
<b>Mbështetja e gatishmërisë së sektorit privat për anëtarësimin në BE, nëpërrmjet aksesit më të mirë në financime dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përrmirësimi i aksesit në financime dhe nxitja e inovacionit në ekonomi.</li> <li>Forcimi i zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe gjithëpërrfshirjes ekonomike</li> </ul>
<b>Forcimi i qeverisjes ekonomike, përrmirësimi i klimës së investimeve dhe avancimi i infrastrukturës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përrmirësimi i klimës së investimeve dhe biznesit</li> <li>Përrforcimi i praktikave të qeverisjes së korporatave</li> <li>Përrmirësimi i ndërlidhjes dhe integritimit të infrastrukturës</li> </ul>

# 5. Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve (1/3)



## Prioriteti 1 Përshpejtimi i tranzicionit të Shqipërisë në Ekonominë e Gjelbër

Objektiva kyç	Veprimtaritë	Treguesit e Gjurmimit
<b>Diversifikimi dhe përshkallëzimi i burimeve të energjisë së rinovueshme</b>	<p>Sigurimi i mbështetjes së politikave përmes Programit të Energjisë së Rinovueshme dhe financimit të nevojshëm për të vazhduar zhvillimin e sektorit të energjisë së rinovueshme dhe mbështetja e Shqipërisë në përmbushjen e kushteve të Axhendës (Programit) të reformave, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator; asistimin në hartimin dhe zbatimin e tenderëve konkurrues (ankandëve) dhe/ose mekanizmave të tjerë për të përshkallëzuar RES.</li> <li>• Angazhimin në politikat që lehtësojnë integrimin e burimeve të rinovueshme në rrjet, si dhe zbatimin i zgjidhjeve për ruajtjen dhe modernizimin e zgjerimin e rrjetit (përfshirë rrjetin ndërkuftar).</li> <li>• Financimin dhe mbështetjen e politikave për përmirësimin, digjitalizimin dhe zgjerimin e transmetimit të energjisë (duke përfshirë lidhjet ndërkufitare) dhe rrjeteve të shpërndarjes dhe mbështetjen e integrimin të Shqipërisë me sistemet rajonale të energjisë.</li> <li>• Ofrimin e ndihmës teknike për zhvillimin e parkut eolik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitetet e energjisë së rinovueshme të instaluar (Më)</li> <li>• Kuadri ligjor, institucional ose rregullator për burimet e rinovueshme është përmirësuar</li> </ul>
<b>Rritjen dhe Mbështetjen e qëndrueshmërisë në të gjithë ekonominë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetja e Shqipërisë në arritjen e synimeve të përvijuara në dokumentet strategjike (NECP, NDC) dhe Agjendën e Reformës.</li> <li>• Promovimi i eficiencës dhe qëndrueshmërisë së energjisë në të gjitha segmentet e ekonomisë, me fokus të veçantë në tregtinë me pakicë, sektorin korporativ dhe NVM-të, si dhe dekarbonizimin e sektorit të ndërtimit—duke përfshirë pasuritë e paluajtshme komerciale, sektorin e hotelerisë, ndërtesat publike dhe rezidenciale—do të realizohet përmes financimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, si dhe angazhimit me politika.</li> <li>• Financimi i shërbimeve të qëndrueshme publike dhe bashkiake (furnizimi me ujë, trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbetjeve bashkiake, transporti urban dhe infrastruktura e tarifimit) duhet të përfshijë gjithashtu Kornizën e Qyteteve të Gjelbra.</li> <li>• Mbështetja selektive e kërkimit dhe prodhimit të metaleve dhe mineraleve thelbësore, si në sektorin parësor ashtu edhe në atë dytësor, për të lehtësuar tranzicionin e energjisë së gjelbër, zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe avancimin e zhvillimit ekonomik më të gjerë, në përputhje me Strategjinë e Minierave të BERZH-it.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Energjia primare e kursyer (GJ/vit)</li> <li>• Ulja e emetimeve totale të CO2 (ktonnes/vit)</li> </ul>
<b>Përmirësimi i reziliencës së klimës dhe qeverisjes së gjelbër</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetja e PFI-ve, rregullatorëve dhe ndërmarrjeve është esenciale për përmirësimin e klimës korporative dhe qeverisjen e qëndrueshmërisë, duke shtuar kapacitetet për menaxhimin e risqeve të lidhura me klimën, si dhe për të zhbllokuar investimet e gjelbra.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i palëve përkatëse të interesit që përmirësojnë praktikatat e qeverisjes për ndryshimet klimatike.</li> </ul>



# 5. Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve (2/3)



## Prioriteti 2: Mbështetja e gatishmërisë së sektorit privat për anëtarësim në BE, nëpërmjet aksesit më të mirë në financime dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor

Objektiva kyç	Veprimtaritë	Treguesit e Gjurmimit
<b>Përmirësimi i aksesit në financime dhe nxitja e inovacionit në ekonomi.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e gatishmërisë së sektorit privat për të hyrë në tregun e vetëm të BE-së, përmes rritjes së financimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, është thelbësore për të përmirësuar konkurrencën, qëndrueshmërinë dhe integrimin e bizneseve vendore në zinxhirët e vlerës globale.</li> <li>Lehtësimi i aksesit në financa për NVM-të dhe korporatat në sektorët prioritarë, përfshirë agrobiznesin, arrihet përmes linjave të kredisë të financuara, instrumenteve të ndarjes së rrezikut (si AASTF, PRS, RSF), produkteve për lehtësimin e kapitalit (MREL), garancive, obligacioneve korporative, si dhe mundësive të financimit të borxhit përmes fondit të investimeve ENEF II.</li> <li>Mbështetja e zhvillimit të tregjeve të parasë dhe kapitalit në sektorin financiar, përfshin tregjet e letrave me vlerë, dhe tregjet e derivateve dhe faktoringut.</li> <li>Mbështetja e gatishmërisë së SME-ve për anëtarësimin në BE dhe rritja e produktivitetit, standardeve, inovacionit, përvetësimit të teknologjisë/digjitalizimit dhe zgjerimit rajonal përmes financimit të synuar dhe shërbimeve këshillimore, duke përfshirë programin ASB dhe Blue Ribbon.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i korporatave dhe NMV-ve të financuara</li> <li>numri/vëllimi i huave të dhëna për MSME-të nga PFI-të</li> </ul>
<b>Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe gjithëpërfshirjes ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetja e klientëve të korporatave dhe palëve të interesuar publike është thelbësore për zhvillimin e fuqisë punëtore më të kualifikuar dhe gjithëpërfshirëse, përmes krijimit të këshillave të aftësive sektoriale dhe rritjes së mundësive për arsim dhe trajnim profesional, veçanërisht në sektorët e synuar si turizmi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) si dhe sektori i energjisë.</li> <li>Lehtësimi dhe përmirësimi i aksesit në financa dhe këshillim për të rinjtë dhe gratë përmes programeve si 'Gratë në Biznes' dhe 'Rinia në Biznes', si dhe zhvillimi i dialogut të synuar për politika.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>N. / Vëllimi i kredive të lëvruara nga PFI-të për bizneset e drejtuara nga të rinjtë dhe gratë.</li> <li>Numri i individëve në një grup të synuar që kanë përmirësuar aftësitë si rezultat i trajnimit</li> </ul>



# 5. Kuadri i Aktiviteteve dhe Rezultateve (3/3)



## Prioriteti 3: Forcimi i qeverisjes ekonomike, përmirësimi i klimës së investimit dhe avancimi i infrastrukturës

Objektiva kyç	Veprimtaritë	Treguesit e Gjurmimit
<p><b>Përmirësimi i klimës së investimeve dhe biznesit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Asistimi i autoriteteve për të përshpejtuar harmonozimin me acquis të BE-së dhe zbatimin e Agjendës së Reformave, financohet përmes Instrumenti i BE-së për Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor.</li> <li>Mbështetja e IHD-ve, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së tregut, reformat ligjore dhe rregullatore dhe përdorimin e të gjitha instrumenteve të financimit në dispozicion.</li> <li>Asistimi në zbatimin e praktikave më të mira në rregullimin dhe qeverisjen e sektorit (p.sh., burimet natyrore), për të tërhequr dhe mobilizuar investimet e sektorit privat.</li> <li>Nxitja e një klime investimi të përgjegjshme gjinore, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit, ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve për PFI-të.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një sërë kushtesh nën Axhendën e Reformave që përftojnë nga bashkëpunimi Teknik i BERZH.</li> <li>Një sërë ligjesh dhe rregulloresh që janë aprovuar nga autoritetet shtetërore që përftojnë nga bashkëpunimi Teknik I BERZH</li> <li>Forcimi i kapaciteteve në nivelin institucional për fushën e synuar</li> </ul>
<p><b>Praktikat e qeverisjes së korporatave janë forcuar</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vijimi i promovimit të komercializimit dhe ristrukturimit të SOE-ve të përzgjedhura, duke përdorur kornizën SMART, që do të rezultojë në përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit operacional.</li> <li>Përmirësimi i qeverisjes korporative, sigurisë kibernetike dhe praktikave ESG në sektorët privat dhe publik nëpërmjet bashkëpunimit teknik dhe investimeve strategjike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i klientëve që miratojnë planin e veprimit për qeverisjen e korporatës</li> <li>Numri i klientëve që po zbatojnë komercializimin / ristrukturimin</li> </ul>
<p><b>Përmirësimi i ndërlidhjes dhe integritetit të infrastrukturës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës kyçe të transportit nëpërmjet investimeve dhe asistencës teknike, përfshirë këtu përmirësimin e rrjeteve rrugore, rehabilitimin dhe modernizimin e hekurudhave dhe lidhjeve rajonale, dhe nëse është e aplikueshme edhe elementë të tjerë të logjistikës dhe infrastrukturës së transportit (p.sh. transporti ndërurban, portet dhe aviacioni). Sigurimi i prokurimit gjithëpërfshirës dhe me përgjegjësi shoqërore (ISRP) duke zhvilluar kapacitetet e agjencive publike për të integruar objektivat e përfshirjes në praktikat e tyre të prokurimit.</li> <li>Shqyrtimi i mundësive për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe digjitalizimit të mëtejshëm të ekonomisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i njësive ekonomike familjare që kanë akses në shërbimet e transportit</li> </ul>





# 6. Harta e Partnerëve Ndërkombëtarë që Plotësojnë Fushat e Punës së BERZH

## Fushat e Punës së BERZH

		Sektorët								Temat e Ndërthurura				
		Industria, Tregtia dhe Agrobiznesi				Infrastrukturë e Qëndrueshme		FI		Nismat Strategjike				
Investimet/grantet vjetore të pritshme (€m, 2020-2023)		Agrobiznesi	Prodhimi dhe Shërbimet	Pronat dhe Turizmi	TMT	Burimet natyrore	Energi	Infrastrukturën	Veprimtaria Bankare	FI-të jo pjesë e Bankës	Ekonomia e Gjelbër	Gjithëpërfshirja dhe Gjinia	Valuta Vendase dhe Tregjete Kapitalit	Biznesi i Vogël
Banka Botërore	142	€					€P	€P	P		€P	€P		
KFë	140						€P	€	€		€P	€P		€
BE	136				€P		€P	€P			€P	€P		€P
BEI	47							€	€		€	€		€
AFD	34						€P	€			€P	€P		
<b>BERZH</b>	<b>173</b>	€	€	€		€	€P	€P	€		€P	€P	P	€

€ Fushë me investime të konsiderueshme ● Përqendrim kryesor në sektorin privat  
 P Fushë me angazhim të konsiderueshëm në politika ○ Përqendrim kryesor në sektorin publik

Shënim: Hartëzimi i veprimtarisë së IFI-ve bazuar në informacionin publik të disponueshëm. Investime të konsiderueshme nga IFI-të përcaktohen si projekte me investim vjetor më shumë se 5% dhe nënshkruar që prej 2020-ës.

## Fushat e Mundshme të Bashkëpunimit

### e Gjelbër

Shfrytëzimi i mbështetjes së donatorëve për të vijuar asistencën teknike dhe për të nxitur dialogun politik në procesin e reformave të mëtejshme në sektorin e energjisë së rinovueshme dhe rritja e koordinimit me BE në mbështetje të kushteve në Axhendën e Reformave sipas Programit të Planit të Rritjes së BE

### I Integruar

Vazhdimi i bashkëpunimit me BE-në dhe BEI-në sipas eBIF, për të mbështetur zhvillimin e projekteve strategjike të infrastrukturës.

### Përfshirës

Zgjerimi i mbështetjes me partnerët e sektorit publik dhe privat për iniciativa të reja trajnimi në sektorë kyç si turizmi dhe energjia.

### E mirëqeverisur

Koordinimi me partnerët ndërkombëtarë për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të promovuar përpjekjet për të zbatuar reformat SOE.

# 7. Risqet e Zbatimit dhe Ndikimet Mjedisore dhe Sociale



Risqet ndaj Zbatimit të Strategjisë	Probabiliteti	Efkti	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kapaciteti i kufizuar institucional mund të shkaktojë vonesa në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të sektorit publik</li> </ul>	●	●	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimit të M&amp;S:</b> Garantimi që ndikimet dhe alternativat e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe kumulative të projektit të vlerësohen në përputhje me Direktivën e BE-së për VNM, ESP të BERZH-it dhe PR-të përkatëse; dhe që instrumentet shoqëruese përmbushin objektivat e PR-ve. Mbështetja e klientëve për të forcuar kapacitetet e menaxhimit të E&amp;S, duke identifikuar hendeqet midis kërkesave kombëtare dhe praktikave të rekomanduara nga BERZH-i, si dhe duke bërë publike dokumentet e E&amp;S sipas kërkesave të ESP dhe AIP/DAI.</li> <li><b>Kushtet e Punësimit dhe Punës:</b> Garantoni që politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore të klientëve dhe punëdhënësve të palëve të treta të jenë në përputhje me kërkesat e BERZH-it dhe BE-së për promovimin e mundësive të barabarta, përfshirjen ekonomike, respektimin e të drejtave të punës, menaxhimin e ndikimit të shkurtimeve masive nga puna dhe parandalimin e diskriminimit të mundshëm ndaj pakicave dhe grupeve të cenueshme. Planifikimi i hershëm dhe alokimi i duhur i burimeve për të menaxhuar dhe mbikëqyrur kontraktorin.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Sfidat demografike dhe emigracioni mund të ndikojnë negativisht në dinamikën e fuqisë punëtore, duke penguar nxitësit strukturorë të rritjes.</li> </ul>	●	●	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Kontrolli i ndotjes:</b> Sfidat janë ende të pranishme në mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve dhe ujërave të zeza, si dhe në reduktimin e ndotjes së ajrit. Ofrimi i mbështetjes për klientët për të siguruar përputhshmërinë me Direktivat përkatëse të BE-së, si dhe për të përmirësuar efikasitetin e proceseve specifike të industrisë në përputhje me BAT dhe GIP, duke reduktuar emetimet GHG.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Cenueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike ka rezultuar në një rritje të shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit, si për shembull thatësira e vitit 2022, të cilat kanë ndikuar në furnizimin e energji elektrike.</li> </ul>	●	●	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Shëndeti, Siguria dhe Sigurimi:</b> Synon të përmirësoni standardet OH&amp;S në të gjithë sektorët, veçanërisht sigurinë në ndërtim dhe funksionim, duke përfshirë vlerësimin e risqeve të H&amp;S për komunitetet. Siguria rrugore dhe e qarkullimit, si dhe risqet e lidhur me projektet e turizmit janë çështjet prioritare ku mund të jetë i nevojshëm angazhimi me klientët dhe palëve të tjera të interesit.</li> <li><b>Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme:</b> Sigurimi i angazhimit kuptimplotë, kompensimit të drejtë dhe restaurimit të jetesës për ata që preken nga projektet ku është e nevojshme blerja e tokës nëpërmjet shpronësimit që shkakton zhvendosje fizike dhe/ose ekonomike. Përgatitja e Kornizës dhe/ose Planit të Zhvendosjes do të jetë i nevojshëm për të siguruar që blerja e tokës për projekte të kryhet në përputhje me PR5, duke përfshirë harmonizimin e legjislacionit kombëtar dhe PR5 mbi konsultimin, të drejtat dhe konsideratat e atyre pa përfaqësues ligjorë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Cenueshmëritë e jashtme të shtuara mund të ndikojnë negativisht në interesin e investitorëve të huaj për investime afatgjata.</li> </ul>	●	●	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Ruajtja e Biodiversitetit dhe Administrimi i Qëndrueshëm i Burimeve të Gjalla Natyrore:</b> Vlerësimi i risqeve dhe ndikimit të aktiviteteve të projektit dhe shërbimeve në florën, faunën, dhe ekosistemeve të zonave të mbrojtura ligjërisht dhe të njohura ndërkombëtarisht për vlerat e biodiversitetit. Shqyrtimi i mundësive për të mbështetur klientët në vlerësimin e këtyre risqeve duke bërë publike të dhënat për biodiversitetin dhe duke promovuar Praktikën e Mira Ndërkombëtare. Kërkoni mundësi për përfitime të qëndrueshme nga biodiversiteti dhe për një rimëkëmbje më të gjerë dhe më efektive të natyrës.</li> <li><b>Trashëgimia Kulturore:</b> Sigurimi i vlerësimit të duhur, shpërndarjen e burimeve dhe konsultimin e palëve të interesuara në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e projektit për të mbrojtur trashëgiminë kulturore.</li> <li><b>Ndërmjetësit Financiarë:</b> Garantimi që FI-të partnere të forcojnë kapacitetin dhe sistemet e administrimit të riskut të M&amp;S.</li> <li><b>Publikimi i informacionit dhe angazhimit të palëve të interesit:</b> Mbështetja e klientëve në angazhimin proaktiv të palëve të interesuara gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit ka si prioritet mbrojtjen dhe mosdiskriminimin e individëve të prekur dhe grupeve të cenueshme, si dhe menaxhimin efektiv të ankesave, konsultimeve dhe raportimeve, duke përfshirë ato të realizuara në kuadër të lejeve vendore dhe VNMS-së.</li> </ul>

● I lartë   ● Mesatar   ● E ulët



## 8. Vlerësimi i Partneriteteve të Donatorëve

### Vlerësimi i Nevojave për Periudhën e Strategjisë së Re për Vendlindjen

Për të arritur objektivat e strategjisë së re të vendlindjes, do të jetë e nevojshme të sigurohen fonde nga donatorët për të mbështetur disa aktivitete kryesore:

- Instrumentet e ndarjes së riskut për të përmirësuar aksesin në financime për gratë, të rinjtë dhe grupe të tjera të marginalizuara.
- Grantet TC dhe kapitale për financimin e shërbimeve këshillimore për NVM-të, rritjen e konkurrencës së tyre, përmirësimin e qeverisjes së korporatave dhe forcimin e praktikave të ESG-ve si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.
- Grantet nxitëse për të inkurajuar përafrimin me rregulloren e BE-së, për të promovuar investimet në teknologjitë e gjelbra dhe fusha të tjera kritike.
- Grantet kapitale dhe TC janë të nevojshme për të lehtësuar financimin e infrastrukturës së transportit dhe për të ofruar mbështetje teknike këshillimore për agjencitë e transportit.
- TC dhe grantet nxitëse për të mbështetur zbatimin e ankandeve të energjisë diellore dhe të erës, ndihmuar autoritetet në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të gjelbra dhe strategjive sektoriale dhe promovimin e komercializimit dhe ristrukturimit të SOE-ve të përzgjedhura.


### Burimet e Mundshme të Fondeve nga Donatorët

- Grantet e TC për përgatitjen e projekteve dhe këshillat e biznesit për politikat parashikohen të jenë të aksesueshme nga një sërë donatorësh dypalësh, duke përfshirë Zvicrën, Italinë dhe Austrinë.
- HIPCA është një komponent kyç për projektet e lidhura me klimën, të cilat shfrytëzojnë grantet e TC dhe instrumentet e investimeve të përbashkëta të ofruara për të nxitur zhvillimin dhe zbatimin e projekteve.
- Sipas ëBIF, BE-ja do të vazhdojë të shtojë fondet e saj (grantet dhe garancitë) për projektet prioritare të sektorit publik dhe privat në fushat e transportit, energjisë, mjedisit dhe klimës, zhvillimit digjital, kapitalit njerëzor dhe konkurrencës së sektorit privat. Instrumentet e bashkëinvestimit dhe grantet TC do të vazhdojnë të spikasin në garancitë e pafinancuara EFSD dhe EFSD+.
- Fondi i Gjelbër i Klimës (GCF) dhe Instrumenti Global i Mjedisit (GEF) do të ofrojnë grante TC për përgatitjen, zbatimin, kërkimin dhe shpërndarjen e projekteve, si dhe kredi koncesionare për të ndihmuar në përparimin e projekteve të fokusuar në klimën.
- Fondi i Ndikimit të Biznesit të Vogël, Fondi Special i Monedhave Lokale të SME-ve dhe Fondi Special i Aksionarëve do të vazhdojnë të ofrojnë instrumente të bashkëinvestimit dhe grante TC sipas alokimeve të tyre rajonale.


### Treguesit e Përzgjedhur të Përballueshmërisë

	BERZH renditja e përqindjeve <sup>1</sup>	
PBB-ja për frymë, (konstante PPP, ndërkombëtare. \$) <sup>2</sup>	18,037	39%
Vend ODA	Po	Nuk ka
ODA si pjesë e të Ardhurave Kombëtare Bruto (%) <sup>3</sup>	3.52	65%
ODA për frymë (\$ - çmimet aktuale) <sup>3</sup>	221.94	83%

### Përdorimi i Burimeve Koncesionare<sup>4</sup>



### Përdorimi i Burimeve Koncesionare nga TQ<sup>5</sup>



1. Rënditja thjeshtë e përqindjeve e raportuar si përqindja e ekonomive të BERZH-it të përfaqësuara më poshtë Albania. 2. IMF ëEO. '24 3. OECD (2021). Shumat bazohen në vlerat e paracaktuara të angazhimit dhe nuk përfshijnë bashkëfinancimet WBIF/EU IPA 5. Bazuar në cilësinë parësore të tranzicionit të burimeve koncesionare.

Shtojcë



**European Bank**  
for Reconstruction and Development



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (1/9)

*Shqipëria është angazhuar dhe ka zbatuar parimet politike të përcaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës që nga miratimi i Strategjisë së mëparshme për Vendin, në përputhje me përpjekjet për zbatimin e agjendës gjithëpërfshirëse të përafrimit me BE-në.*

Angazhim kyç për reformat mbetet procesi i përafrimit me BE-në. Në vitin 2014, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat për në BE. Më 15 tetor 2024, BE-ja hapi Grupkapitullin 1 (“Themeloret”) e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, i cili përbëhet nga pesë kapituj negociues dhe tre fusha, përfshirë këtu edhe kapitujt kritikë për Shtetin e së Drejtës. Më 23 tetor 2024, Komisioni Evropian miratoi Agjendën e Reformave të Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje, i cili është pjesë e Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Madje, është vënë në zbatim kuadri kushtetues dhe legjislativ për një demokraci parlamentare pluraliste. Sipas vlerësimit të Këshillit të Evropës, ndarja e pushteteve dhe kontrollet dhe ekuilibrat në sistemin politik, garancitë për të drejtat themelore dhe mbrojtjen e pakicave dhe për rolin kuptimplotë të shoqërisë civile janë gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Që prej miratimit të Strategjisë së mëparshme, Shqipëria ka përparuar në reformat demokratike. Në fushat që konsiderohen si dobësi për vendet e Ballkanit Perëndimor janë bërë përmirësime – shteti i së drejtës. Në veçanti, autoritetet po vazhdojnë me një reformë të plotë të sistemit të drejtësisë, që ka nisur në vitin 2016 dhe është hartuar për të rritur pavarësinë, integritetin dhe përgjegjshmërinë e tij. Autoritetet kanë ndërmarrë një nismë të re reforme mbi “Qeverisjen e Mirë, Shtetin e së drejtës dhe Luftën kundër Korrupsionit për Shqipërinë 2030”.

Pavarësisht përparimeve të përmendura më lart, ende ka sfida të rëndësishme, përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Autoritetet duhet të forcojnë hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet në rastet e korrupsionit, pasi janë shqetësuese. Nevojiten përpjekje të qëndrueshme për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe trajtimin e ekonomisë informale.

## Zgjedhjet e Lira dhe Qeveria Përfaqësuese

### Zgjedhje të lira, të drejta dhe konkurruese

Në Shqipëri, zgjedhjet mbahen zakonisht në një mënyrë që OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës i konsiderojnë të lira, të ndershme dhe konkurruese. Kuadri ligjor ofron bazën për zgjedhjet demokratike, kur ka vullnet politik për zbatimin e duhur të tij. Ky kuadër ka përfituar nga një sërë reformash zgjedhore, përfshirë ndryshimet e mëdha të bazuara në rekomandimet e Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Këshillin e Evropës.



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (2/9)

Komisioni për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias). Të miratuara në vitin 2024, ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor mundësuan votimin jashtë vendit nga diaspora shqiptare dhe prezantuan lista kandidatësh të hapura pjesërisht. Katër zgjedhjet e fundit në Shqipëri (2009, 2013, 2017 dhe 2021) ishin paqësore. Kjo gjë tregon një arritje të rëndësishme krahasuar me zgjedhjet e kaluara, të cilat shpesh shoqëroheshin me dhunë. Megjithatë, sipas OSBE-së, besimi publik në procesin zgjedhor vazhdon të ulet për shkak të mangësive procedurale dhe akuzave për blerje votash, si dhe keqpërdorimit të burimeve administrative në favor të partisë në pushtet.

Sipas Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, zgjedhjet e fundit të përgjithshme të mbajtura më 25 prill 2021 u zhvilluan në mënyrë të rregullt, ku konkurrentët patën mundësi të bënin fushatë lirisht<sup>1</sup>. Në disa qendra votimi u prezantuan për herë të parë si projekt pilot votimi elektronik dhe teknologjitë e reja për votimin dhe numërimin. Kjo ishte pjesë e rëndësishme e marrëveshjes politike midis partive në pushtet dhe opozitës, e cila riktheu opozitën në procesin politik pas bojkotimeve të mëparshme dhe reformës zgjedhore të vitit 2020. Edhe zgjedhjet e vitit 2021 përforcuan garancitë për balancën gjinore, gjë që solli rritjen e përqindjes së deputeteve në parlamentin e ri.

Raporti përfundimtar mbi zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, i lëshuar nga OSBE/ODIHR, theksoi nevojën për adresimin e disa rekomandimeve të mbetura pezull nga OSBE-ja dhe Komisioni i Venecias, përfshirë ato që lidhen me depolitizimin e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta dhe përdorimin e materialeve të fushatës së partive në media, si dhe heqjen e kufizimit të të drejtave të votës (që lidhen me shëndetin mendor) dhe garancive për të njëjta të drejta për të gjithë vëzhguesit.

Të mbajtura më 14 maj 2023, zgjedhjet e fundit vendore u administruan mirë dhe ishin konkurruese<sup>2</sup>. Megjithatë, procesi u karakterizua nga polarizimi ekstrem i vazhdueshëm midis partive politike kryesore dhe për më tepër, nga ndarjet e hidhura brenda opozitës. Sikurse ndodhi në rastin e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, akuzat për blerje votash vazhduan. Dy ditë para zgjedhjeve, një kandidat për kryetar bashkie në Himarë, politikani me etni greke Fredi Beleri nga koalicioni Bashkë Fitojmë, u ndalua me akuzën për blerje votash dhe më pas u dënua me burg. Gjykatat i refuzuan apelimet e vazhdueshme. Megjithatë, ai fitoi zgjedhjet nga burgu. Në vitin 2024, rezultatet zgjedhore në Himarë u anuluan formalisht dhe u organizua një votim i ri. Rasti i Belerit tërhoqi vëmendjen për shkak të reagimit të fortë nga autoritetet greke dhe faktit se në vitin 2024 ai u zgjodh si anëtar në Parlamentin Evropian në listën e partisë qeverisëse greke ND. Në vitin 2024, Beleri u lirua me kusht pasi kishte shërbyer dy të tretat e dënimit të tij.

## Ndarja e pushteteve dhe kontrolleve dhe ekuilibrave efikas

Sipas vlerësimit të Këshillit të Evropës, kuadri kushtetues dhe legjislativ për një demokraci parlamentare, që bazohet në ndarjen e pushteteve dhe kontrollet dhe ekuilibrat në sistemin politik, në një legjislaturë të pavarur dhe në procedura të mirëpërcaktuara të mbikëqyrjes parlamentare në

1. OSBE/ODIHR, Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri më 25 prill 2021, Raporti përfundimtar, 26.07.20215.

2. OSBE/ODIHR, Zgjedhjet bashkiake në Shqipëri më 14 maj 2024, Raporti përfundimtar.



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (3/9)

fushat e përcaktuara të vendimmarrjes, janë të ngritur në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane në Shqipëri.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare është edhe qëllimi i pushtetit të legjislaturës për t'i kërkuar llogari qeverisë dhe për të ushtruar mbikëqyrje parlamentare. Parlamenti i 140 deputetëve me një dhomë zgjidhet për një mandat katërvjeçar përmes një sistemi të modifikuar të përfaqësimit proporcional rajonal me votim preferencial. Në përgjithësi, ka pasur përparime në funksionimin e parlamentit, përfshirë transparencën dhe përfshirjen e procesit ligjvënës. Megjithatë, ndryshimet e fundit në ligjin për komitetet e hetimit janë kritikuar për kufizimin e rolit mbikëqyrës së parlamentit dhe aktualisht janë nën shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Sipas vlerësimit të KE-së, mbikëqyrja parlamentare e ekzekutivit mbetet e kufizuar<sup>3</sup>. Presidenti, i cili ka rol kyç ceremonial, zgjidhet nga parlamenti përmes një sistemi të ndërlikuar, i cili zakonisht përfshin disa raunde votimi. Gjykata Kushtetuese, e cila ishte paralizuar në fillim të procesit të "vlerësimit kalimtar" (shihni seksionin më poshtë për shtetin e së drejtës), tani funksionon plotësisht me të nëntë gjyqtarët në detyrë dhe është efektive në mbrojtjen e kontrollove dhe balancave kushtetuese.

## Pushteti efektiv i zyrtarëve të zgjedhur për të qeverisur

Shqipëria ka bërë marrëveshje institucionale, ligjore dhe financiare që zyrtarët e zgjedhur të ushtrojnë në mënyrë të efektshme pushtetin për të qeverisur. Ata nuk kufizohen nga fuqitë jodemokratike të vetos ose nga ndikimet e tjera të papërshtatshme. Si në shumë vende të tjera në tranzicion, biznesi dhe elita politike kanë pasur marrëdhënie të ngushta për një kohë të gjatë. Megjithatë, kjo nuk duket të ndikojë në pushtetin e zyrtarëve të zgjedhur për të qeverisur vendin.

## Shoqëria Civile, Media dhe Pjesëmarrja

### Shkalla dhe pavarësia e shoqërisë civile

Është ngritur një kuadër i kënaqshëm ligjor për organizatat e shoqërisë civile (OSHC), që është përmirësuar vitet e fundit, ku përfshihen ligje lidhur me funksionimin e organizatave jofitimprurëse. Procesi për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve është relativisht i thjeshtë dhe përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, ka çështje të pazgjidhura lidhur me përkufizimin e veprimtarive jofitimprurëse, raportimin financiar dhe tatimin. Bashkëpunimi midis shtetit dhe OSHC-ve është përmirësuar. OSHC-ve iu bëhet konsultim më i rregullt për nismat politike dhe ligjore në krahasim me të kaluarën. Megjithatë, proceset e ndjekjes së mëtejshme duhet të përmirësohen. Transparenca e kufizuar dëmton nismat e advokimit të OSHC-ve, ndërsa imazhi publik i sektorit të shoqërisë civile preket negativisht nga sulmet mediatike ndaj OSHC-ve dhe aktivistëve. Nuk është bërë asnjë përparim në zbatimin e Udhëzuesit të Qeverisë për një Mjedis të Përshtatshëm për Shoqërinë Civile 2019-2023<sup>4</sup>.

3. Raporti i Shqipërisë 2024, Komunikimi për politikën e zgjerimit të BE-së 2024, Komisioni Evropian, 30.10.2024.

4. Po aty



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (4/9)

Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, aktualisht janë regjistruar rreth 12,240 OSHC. Sipas autoriteteve tatimore, 2,217 OSHC janë financiarisht aktive. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i OSHC-ve, kryesisht në qytetet e mëdha, janë të mirëorganizuar dhe mirëfinancuara. Matrica e Monitorimit të Mjedisit të Përshtatshëm për Zhvillimin e Shoqërisë Civile zbuloi se trajtimi fiskal i sektorit, përfshirë mungesa e rikthimeve të TVSH-së për grantet, vazhdon të ndikojë negativisht në operacionet dhe aktivitetet e OSHC-ve. OSHC-të mbeten ofruesit kryesorë privatë të shërbimeve sociale në vend. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve nga OSHC-të varet shumë nga mbështetja e donatorëve. Pak OSHC gjenerojnë të ardhura përmes këtyre aktiviteteve, gjë që paraqet një sfidë për qëndrueshmërinë e tyre. Për më tepër, sektori i shoqërisë civile mbetet i fragmentuar dhe tejet i varur nga financimi i donatorëve të jashtëm, ndërkohë që vitet e fundit është vënë re tërheqja e shumë donatorëve të huaj për shkak të riorientimit të tyre në rajone të tjera. Donatorët e huaj, përfshirë institucionet e Bashkimit Evropian, ambasadat e huaja, agjencitë e zhvillimit dhe institucionet e partive politike të huaja, vazhdojnë të jenë burimi më i rëndësishëm i financimit të OSHC-ve në Shqipëri.

E drejta për të krijuar sindikata është e parashikuar në ligj dhe të drejtat e punës dhe sindikatave respektohen përgjithësisht në praktikë.

## **Pavarësia dhe pluralizmi i medias vepron pa censurë**

Gjatë viteve të fundit, pluralizmi i mediave që operojnë lirisht dhe pa censurë është rritur në përgjithësi. Kuadri ligjor zbatohet gjerësisht dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ndërsa mjedisi mediatik ka shumë kanale mediatike, me numrin më të lartë për banorë në rajon, ai kufizohet nga një treg i limituar reklamash që përqendrohen te disa kanale. Mungesa e transparencës në financimin e tyre dhe rregullimi i kufizuar (sidomos mediat online nuk rregullohen) janë probleme që ekzistojnë prej kohësh. Në treg mbizotëron media elektronike. Burimi kryesor i informacionit politik mbetet televizioni, veçanërisht në zonat rurale. Përveç transmetuesit publik (RTSh), për të cilin vihet në dyshim pavarësia e tij, ka disa kanale private kombëtare dhe një numër të madh transmetuesish privatë rajonale dhe vendorë. Faqet e internetit dhe rrjetet sociale po zëvendësojnë me shpejtësi shtypin. Viteve të fundit është vënë re një rritje e jashtëzakonshme e qasjes në internet.

Kohët e fundit janë bërë disa ndryshime në kodet civile dhe penale, të cilat sollën heqjen e dënimeve me burgim për shpifje. Megjithatë, ende nuk është arritur dekriminalizimi i plotë i shpifjes dhe fyerjes. Kuadri për mbrojtjen e gazetarëve po zbatohet në përgjithësi. Megjithatë, vazhdojnë të raportohen sulme verbale dhe fizike, si dhe numër i lartë i padive SLAPP.





# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (5/9)

---

## Kanale të shumta për pjesëmarrje civile dhe politike

Funksionojnë kanale të shumta për pjesëmarrje qytetare dhe politike, por zbatimi i masave mbrojtëse dhe rregullave ekzistuese, veçanërisht në lidhje me konsultat publike, shihet nga disa vëzhgues si mangësi në efikasitet. Komisionet parlamentare u kërkojnë shpesh OSHC-ve të ofrojnë ekspertizë, e cila kryhet sipas nevojës. Dokumentet e paraqitura për konsulta publike u prezantohen publikut me një njoftim shumë të shkurtër, ndërsa masat për të inkurajuar pjesëmarrje të gjerë dhe ndërgjegjësim të publikut nuk garantohen gjithmonë, veçanërisht lidhur me konsultat mbi iniciativat legjislative të parlamentit.

## Liria për të themeluar parti politike dhe ekzistenca e opozitës së organizuar

Liria për të themeluar parti politike është e garantuar nga Kushtetuta dhe e zbatuar në terma praktikë. Kjo theksohet nga prania e një opozite të konsiderueshme, që është e aftë të bëjë fushatë dhe t'i kundërvihet lirshëm nismave qeveritare. Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri morën pjesë dhjetë parti politike dhe dy koalicione, katër prej të cilëve fituan vende në parlament. Partia kryesore e opozitës ka rreth 40 përqind të vendeve në parlament dhe përfaqësuesit e saj drejtojnë disa komisione parlamentare.

## Shteti i së Drejtës dhe Qasja në Drejtësi

### Mbizotërimi i Ligjit

Masat e nevojshme legjislative dhe institucionale për mbizotërimin e ligjit janë të përcaktuara. E drejta për një gjykim të drejtë dhe liria kundër ndalimit dhe burgimit arbitrar janë të parashikuara në Kushtetutë dhe në kodin penal. Mbizotërimi i ligjit është përmirësuar si rrjedhojë e reformës aktuale gjithëpërfshirëse të sektorit të drejtësisë, përfshirë ristrukturimin institucional dhe rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (vlerësimi kalimtar).

### Pavarësia e gjyqësorit

Kushtetuta garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Reforma gjithëpërfshirëse e gjyqësorit, e cila nisi në vitin 2016 dhe solli ristrukturimin e të gjithë sistemit të drejtësisë, ka ecur përpara duke konsoliduar pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien. Ristrukturimi institucional dhe vazhdimi i zbatimit të sistemit radikal të "vlerësimit kalimtar" (ri-vlerësimit të të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve etj.),



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (6/9)

i mbikëqyrur nga palë ndërkombëtare, me më shumë se 50% të dosjeve të vlerësimit kalimtar që sjellin shkarkime, dorëheqje ose përfundim mandati), kanë rritur integritetin e sistemit të drejtësisë, kanë ulur ndikimin politik dhe kanë forcuar llogaridhënien. Procesi i vetingut për shkallën e pare është afër përfundimit<sup>5</sup>.

## Qeveria dhe qytetarët të barabartë përpara ligjit

Reforma gjithëpërfshirëse e sistemit të drejtësisë po sjell rezultate pozitive në forcimin e parimit që qeveria dhe qytetarët janë të barabartë përpara ligjit.

## Politika dhe institucione efikase për parandalimin e korrupsionit

Sipas perceptimit të publikut, ekspertëve dhe bizneseve, ekziston një nivel i lartë i korrupsionit në sektorin publik. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (IPK) të Transparency International për vitin 2023, Shqipëria është në vendin e 98-të nga 180 vende të vlerësuara, duke u renditur në vendin më të ulët ndër vendet e Evropës Juglindore<sup>6</sup>.

Që nga miratimi i Strategjisë së mëparshme, autoritetet shqiptare kanë shtuar përpjekjet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kuadri ligjor për luftën kundër korrupsionit zbatohet dhe është në përputhje me standardet Evropiane. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC). Nga Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion (SPAK) vijnë rezultate inkurajuese. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë "kanë vazhduar të japin rezultate të mira në hetimin, ndjekje penale dhe dënime në raste të korrupsionit të nivelit të lartë"<sup>7</sup>. SPAK përfshin Prokurorinë e Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe gjykatat e SPAK-ut. Brenda Zyrës së Kryeministrit është krijuar një platformë bashkëqeverisjeje, e cila lejon qytetarët dhe bizneset të raportojnë aktet e dyshuara të korrupsionit, të cilat i kalohen Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit që koordinon një rrjet koordinatorësh në nivel qendror dhe vendor. Që nga periudha e Strategjisë së mëparshme të shtetit, numri i personave të hetuar, të ndjekur penalisht dhe të dënuar për korrupsion ka ardhur në rritje. Ndër personat e dënuar kanë qenë deputetë dhe ish-anëtarë të qeverisë. Në vitin 2024, një Ministër Shteti për Reformën në Administratën Publike dhe Anti-Korrupsion u emërua si koordinues i masave kundër korrupsionit në shërbimet e qeverisë. Megjithatë, koordinimi midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe strukturave përkatëse të zbatimit të ligjit mbetet i dobët. Ndërsa, kompetencat në këtë fushë janë të shpërndara midis disa autoriteteve<sup>8</sup>.

5. Raporti i Shqipërisë 2024, Komunikimi për politikat e zgjerimit të BE-së 2024, Komisioni Evropian, 30.10.2024.

6. Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (IPK) 2023, Transparency International, 2024

7. Raporti i Shqipërisë 2024, Komunikimi për politikat e zgjerimit të BE-së 2024, Komisioni Evropian, 30.10.2024.

8. Raporti i BE-së për Shtetin e së Drejtës, Shqipëri, Korrik 2024



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (7/9)

Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Shqipërisë theksoi bashkëpunimin e mirë me shtetet anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së në luftën kundër korrupsionit<sup>9</sup>.

## Të Drejtat Civile dhe Politike

Liria e fjalës, informacionit, besimit fetar dhe ndërgjegjes, lëvizjes, organizimit, tubimit dhe pronës private.

Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligjet përkatëse ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë, racës, gjuhës, besimit fetar, prejardhjes kombëtare ose sociale, pronës ose statusit social. Kushtetuta garanton liritë dhe të drejtat bazë të qytetarëve të njohura nga e drejta ndërkombëtare. Ndërkohë, traktatet ndërkombëtare zbatohen direkt nga gjykatat vendase, të cilat vijnë më lartë në hierarki se sa legjislacioni vendas.

Shqipëria ka nënshkruar të gjitha instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Arritje e rëndësishme është shkalla e lartë e ratifikimit të konventave të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe instrumenteve rajonale për të drejtat e njeriut. Shqipëria ka ngritur edhe kuadrin institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili përfshin institucionin e Avokatit të Popullit, një sërë organesh shtetërore dhe ndërministrorë, këshilla kombëtare, si dhe sekretariate teknike brenda ministrive. Sfidat kryesore me të cilat përballet Shqipëria lidhen me sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin dhe monitorimin e këtyre instrumenteve.

Garancitë kushtetuese të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar respektohen në përgjithësi. Shqipëria vijon të jetë shembull i harmonisë fetare në rajon. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, nuk ka fe zyrtare dhe të drejtat e të gjitha komuniteteve fetare (kryesisht myslimanëve: suni dhe bektashi) dhe të krishterëve (ortodoks, katolik dhe protestantë) garantojnë në mënyrë të barabartë.

Një nga problemet kryesore mbetet kthimi i pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist dhe zgjidhja e certifikatave dhe pronësisë së tokës. Reforma e të drejtave pronësore është thelbësore për konsolidimin e shtetit të së drejtës, po aq sa edhe për zhvillimin ekonomik. Në vitin 2019, parlamenti miratoi Ligjin për Kadastrën, i cili duhet të përfundojë regjistrimin e parë të titujve të pronësisë në gjithë vendin. Që nga Strategjia e mëparshme e shtetit, ka pasur përparime në miratimin e legjislacionit zbatues për ligjin për kadastrën dhe ligjin për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë.

Në vitin 2019 u miratua vlerësimi më i fundit i historikut të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut, në kuadër të Rishikimit Periodik Universal (RPU) të Kombeve të Bashkuara. Dy rekomandimet kryesore lidhen me të drejtat e fëmijëve (40 përqind e rekomandimeve) dhe të drejtat e grave (26 përqind). Nga 197 rekomandime të bëra përmes procesit të shqyrtimit, Shqipëria mbështeti 94 përqind<sup>10</sup>.

9. Komunikatë e KE-së për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe KESE mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së, 8.11.2023

10. Statistikat e RPU-së, të disponueshëm në <https://upr-info-database.uëazi.io/en/>



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenit 1 (8/9)

## Përfshirja e grave, etnive dhe pakicave të tjera në politikë

Kuadri ligjor për mbrojtjen e grupeve etnike zbatohet gjerësisht, përfshirë Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjes Kulturore dhe ligjin kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Pakicat etnike marrin pjesë aktive në jetën politike, përfshirë edhe përmes partive të veta politike. Ato janë më të fuqishme në krahasim me fqinjët e rajoneve të tjera dhe më të integruara në partitë politike kryesore (pa bazë etnike).

Shqipëria ka më pak diversitet etnik se shumica e vendeve fqinje në rajon, pasi shqiptarët etnikë përbëjnë më shumë se 90% të popullsisë. Në Shqipëri ka nëntë minoritete kombëtare të njohura zyrtarisht (Arumun, Boshnjak, Bullgar, Egjiptian, Grek, Maqedonas, Malazez, Rom dhe Serb). Sipas vlerësimeve, pakica greke, e cila është pakica më e madhe etnike, zë vetëm pak përqind të popullsisë. Censusi i vitit 2011 përfshiu për herë të parë pyetje alternative për origjinën etnike dhe përkatësinë fetare, ku rreth 14% e të anketuarve zgjodhën të mos përgjigjeshin. I kryer në vitin 2023, censusi i fundit tregoi rezultatet e përbërjes etnike, të cilat u kundërshtuan nga shtetet fqinje me argumentin se minoritetet kombëtare përkatëse nuk ishin numëruar siç duhet. Marrëdhëniet ndëretnike në vend mbeten të mira. Si në shumë vende fqinje, pakicat rome dhe egjiptiane janë grupi më i cenueshëm, të cilët vijojnë të përballen me vështirësi lidhur me qasjen në arsim, strehim dhe punësim.

Elementët legjislativë kyç për barazinë gjinore janë të miratuar në Shqipëri. Ligjet e rëndësishme të miratuara vitet e fundit përfshijnë Ligjin për Barazinë Gjinore në Shoqëri, për Masat Kundër Dhunës, për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Strategjia kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030 dhe plani i saj i veprimtimit janë më mbështetëse në adresimin e të drejtave të grave. Strategjia fokusohet tek individët që përballen me forma të ndërthurura diskriminimi dhe cenueshmërie, tek të rinjtë dhe reformat sociale. Ajo përfshin edhe një seksion për emergjencat humanitare. Megjithatë, duhet të zbatohet gjerësisht<sup>11</sup>. Dhuna familjare kundër grave mbetet problem, sidomos në zonat rurale. Në disa komunitete, gratë përballen me diskriminim shoqëror të bazuar në norma shoqërore tradicionale.

Gratë kanë një numër të konsiderueshëm përfaqësuesesh të shquara në nivel kombëtar. Që nga viti 2017, më shumë se 50 përqind e anëtarëve në qeveritë pasuese shqiptare kanë qenë femra. Në këtë aspekt, qeveria është ndër më të mirat në botë dhe padyshim me pjesën më të madhe të grave në rajon.

11. Raporti i punës së stafit të Komisionit, Raporti i Shqipërisë 2023. 8.11.2023



# Shtojca 1 - Vlerësimi i Politikave në Kontekstin e Nenet 1 (9/9)

Kuotat gjinore në zgjedhje (në zgjedhjet e fundit parlamentare numri i kandidateve kaloi kuotën në shumicën e listave të partive) kanë pasur rritje të qëndrueshme të përfaqësimit të grave në parlament, nga 7 përqind në të kaluarën në 35 përqind në parlamentin aktual të zgjedhur në vitin 2021. Tetë gra, të gjitha përfaqësuese të partisë në pushtet, u zgjodhën kryetare bashkie në zgjedhjet lokale të vitit 2024. Edhe shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Kolegjit Zgjedhor janë gra.

Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ është ende i përhapur në shoqërinë shqiptare, përfshirë aksesin në shërbime shëndetësore, arsim, drejtësi, punësim dhe strehim. Si vëzhguese e punës së Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Shqipëria ishte pjesë e Anketës së Besimit LGBTIQ III në vitin 2023, e cila zbuloi se në Shqipëri 51% e personave ndiheshin të diskriminuar në të paktën një fushë të jetës një vit para anketës (për BE-27 përqindja ishte 37%)<sup>12</sup>. Shqipëria nuk ka legjislacion që njeh bashkëjetesën qytetare ose martesat e të njëjtit seks.

## Liria nga ngacmimi, kanosja dhe tortura

Garancitë kushtetuese kundër ngacmimit, kanosjes dhe torturës janë të miratuara dhe zbatohen gjerësisht në praktikë. Një delegacion i Komitetit Evropian të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese (KPT) vizitoi Shqipërinë për herë të fundit në maj të viti 2023 për të shqyrtuar trajtimin dhe kushtet për ndalimin e personave të mbajtur në paraburgim dhe në burg. Vizita kishte në fokus edhe situatën e pacientëve psikiatrikë mjekoligjorë dhe të burgosurit me çrregullime mendore. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nënshkruan një memorandum mirëkuptimi së bashku me planin e përbashkët të veprimit për të zbatuar rekomandimet e vitit 2021 të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese dhe vendimet e GjEDNj-së lidhur me pacientët psikiatrikë mjekoligjorë dhe të burgosurit me çrregullime mendore.

Për herë të parë në Shqipëri që nga viti 2000, delegacioni i KPT-së shqyrtoi trajtimin e banorëve me aftësi të kufizuara intelektuale në institucionet e kujdesit social. I publikuar në janar të vitit 2024, raporti për vizitën thekson se, megjithëse është vërejtur një tendencë pozitive gjatë vizitave më të fundit të KPT-së në Shqipëri lidhur me trajtimin e personave të ndaluar nga policia, ende kërkohen veprime shtesë për të eliminuar keqtrajtimin nga ana e policisë.<sup>13</sup>

12. Raporti i Shqipërisë 2024, Komunikimi për politikën e zgjerimit të BE-së 2024, Komisioni Evropian, 30.10.2024.

13. Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese (KPT), Raporti për vizitën periodike në Shqipëri nga 4 deri më 15 maj 2023, publikuar më 12 janar 2024.